

## **Intervistë me Kryetarin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasadori Pavel Vacek**

*Gazetare: Alma Çupi*

**Z. Ambasador, vetëm dy javë e ndajnë Shqipërinë nga zgjedhjet parlamentare të 3 korrikut. A mund të na thoni se cilat janë shqetësimet kryesore që ka Prezenca e OSBE-së deri në këto momente lidhur me fushatën zgjedhore?**

Ka disa shqetësime për një sërë parregullsish. Ne jemi më pak të shqetësuar për parregullsitë teknike dhe administrative, të cilat mund të ndreqen. Unë besoj se të gjitha autoritetet përgjegjëse, qoftë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, kryetarët e njësive të qeverisjes vendore apo komisionet zgjedhore po bëjnë më të mirën e mundshme për trajtimin e parregullsive proceduriale dhe administrative. Aktualisht, ne jemi më të shqetësuar nga fakti se ka disa kandidatë të emëruar nga partitë përkatëse, që nuk sillen sipas standardeve më të larta të miratuara nga partitë politike shqiptare të përfshira në kodin e sjelljes.

**Është thënë se këto zgjedhje përbëjnë një test të rëndësishëm për Marrëveshjen e Asociim Stabilizimit? Çfarë mendoni se përbën rrezikun kryesor për këto zgjedhje?**

Çështja kryesore është nëse Shqipëria do të jetë në gjendje të bëjë zgjedhje më të mira dhe sa më në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe angazhimet e OSBE-së. Siç dihet, kjo është sfida që i bën këto zgjedhje kaq të rëndësishme jo vetëm për vetë vendin, demokracinë e tij, por edhe për ambiciet e jashtme të Shqipërisë. Besoj se rreziku që unë shoh është se kombinimi i të gjitha parregullsive individuale të llojeve të ndryshme nuk do ta lejonte Shqipërinë të bënte zgjedhje më të mira në një masë të konsiderueshme.

**Cili është opinionin juaj për fenomenin e Dushkut dhe mënyra se si ai po zbatohet në këtë fushatë?**

Opinionin ynë është formuluar në raportet e nxjerra nga Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it. Ai përfaqëson edhe opinionin tonë dhe, për ta thënë thjesht këtë, është parë se efekti i marrëveshjeve të tilla për një votim taktik është deformues. Ky është një fakt jetësor, që është ditur dhe është vënë në dukje nga ana jonë disa herë.

Unë, personalisht, nuk mendoj se zgjedhësit shqiptarë dinë mjaftueshëm për këto marrëveshje të bëra midis partive për një votim taktik, dhe, për sa kohë ata nuk dinë mjaftueshëm, vështirë se mund të zgjedhin duke qenë të mirëinformuar.

**A mendoni se vonesat në listat e votuesve mund ta vënë në rrezik zhvillimin e zgjedhjeve?**

Ka pasur disa probleme lidhur me listat e zgjedhesve dhe ne, tani, e kemi fjalen per listat perfundimtare. Ne, pa dyshim, jemi perfshire ne mbeshtetjen e autoriteteve shqiptare per prodhimin e listave me te mira zgjedhore. Pa dyshim, ka pasur vonesa ne nivele dhe faza te ndryshme te proceseve, por ne shohim, gjithashtu, qe vonesat kane rezultuar ne veprime korrigjuese. Dhe, pa dyshim, shohim nje permiresim te vazhdueshem, qe eshte edhe falë veprimeve korrigjuese te ndërmarra nga autoritete te ndryshme të përfshira në përgatitjen e listave zgjedhore, si nga Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, ashtu edhe nga vetë kryetaret e njësive vendore. Qellimi ynë ka qenë që të ndihmojmë Shqipërinë të realizojë lista më të mira zgjedhore. Janë investuar burime në to, të cilat kanë ardhur nga Komisioni Evropian dhe ne besojmë se përpjekjet tona, të cilat ne i kemi ndërmarrë bashkarisht me autoritetet shqiptare, do të çojnë në rezultatin e dëshiruar, por ka edhe disa probleme sistemike të trashëguara në sistemin zgjedhor, dhe do të vijmë edhe aty.

### **Cilat janë ankesat kryesore që merr zyra juaj nga partitë politike?**

Ankesat janë të kategorive të ndryshme. Për momentin, nuk do të dalloja ndonjë ankesë kryesore. Sigurisht, disa ankesa lidhen me çështjen e kandidatëve, të tjera me listën e zgjedhësve. Ka, gjithashtu, edhe ankesa dhe kundërshtime lidhur me mënyrën e shpërndarjes së qytetarëve në qendrat e votimit në rajone të ndryshme, por kjo është diçka që është ende në vlerësim e sipër dhe po monitorohet nga Misioni Vëzhgues i Zgjedhjeve. Një vlerësim i paanshëm dhe i plotë i këtyre gjërave do të shfaqet në raportet e Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve dhe, une mendoj se një raport tjetër i përkohshëm do të përgatitet për nja dy ditë, prandaj, për momentin, është shpejt për të bërë vlerësimin e përgjithshëm. Pa dyshim, përveç këtyre ankesave që kanë të bëjnë me aspektin teknik dhe procedural, ka pasur, gjithashtu, edhe probleme politike lidhur me votimin taktik, i cili është kundërshtuar nga disa subjekte politike në skenën shqiptare.

### **A jeni optimist se këto zgjedhje do të shkojnë mirë?**

Duhet të jem optimist. Kjo është pjesë e qëndrimit tonë dhe e mënyrës se si ne i trajtojmë gjërat. Por, në të njëjtën kohë, me afrimin e ditës së zgjedhjeve, ne nuk mund të rrimë pa vëmë re se parregullsitë po shtohen. Unë do të ritheksoja që nuk janë çështjet administrative që mund ta bllokojnë procesin, por janë më shumë çështjet që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e partive politike dhe udhëheqjeve të tyre përkatëse, si dhe me shkallën e përgjegjshmërisë së tyre ndaj sjelljes së njerëzve konkretë, qoftë edhe kandidatë dhe, më konkretisht, në ditën e zgjedhjeve, performancën e administrimit të zgjedhjeve, përfshi këtu performancën e komisioneve zgjedhore. Ky është çelësi për të pasur zgjedhje më të mira sipas standardeve ndërkombëtare.